

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Fall 9-2020

**ABUZIMI ME SUBSTANCA PSIKOTROPE-DROGA DHE ALKOOLI TE
PERSONAT MBI MOSHË 20 VJEQARE**

Urata Kollari

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the **Nursing Commons**



Kolegji UBT

Fakulteti Infermierisë

**ABUZIMI ME SUBSTANCA PSIKOTROPE-DROGA DHE
ALKOOLI TE PERSONAT MBI MOSHË 20 VJEQARE**

Shkalla Bachelor

Urata Kollari

Shtator / 2020 / Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti Infermierisë

Punim Diplome

Viti akademik 2017/2018

Urata Kollari

ABUZIMI ME SUBSTANCA PSIKOTROPE-DROGA DHE ALKOOLI TE PERSONAT MBI MOSHË 20 VJEQARE

Mentori : Gani Halilaj

Shtator/ 2020

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallë Bachelor

ABSTRAKTI

Sipas Raportit Kombëtar për Kosovën (2014) në mbarë botën, përdorimi i drogës dhe substancave të tjera psikotropike dhe psikoaktive paraqet një kërcënim serioz në shëndetin dhe zhvillimin shoqëroro-ekonomik të një komuniteti, veçanërisht duke vënë më të rinjtë në shënjestër. Qëllimi i këtij studimi është të shohim më shumë rreth abuzimit të substancave subtropike-droga dhe alkooli dhe ndikimin e këtyre substancave tek personat mbi moshën 20 vjeçare. Studimi është realizuar gjatë muajit Gusht ku për shkak të pandemisë të krijuar nga COVID 19 pyetësi është shpërndarë në mënyrë elektronike në rrjetin social Facebook. Gjithsej në këtë studim ishin 85 pjesëmarrës

Të dhënat e marrura janë analizuar me Pakon Statistikore të Shkencave Sociale 20 dhe janë bërë këto analiza: deskriptive, korrelacionare, ANOVA dhe regresioni linear.

Nga rezultatet arritëm në përfundim se 28.2% e pjesëmarrësve mendjnë se marijuana është shqetësimi më serioz për komunitetin e përgjithshëm, pastaj 22.4% prej tyre mendojnë se alkooli është një shqetësim, kurse vetëm 1.2% e pjesëmarrësve mendojnë se asnjëra nga këto nuk paraqesin ndonjë shqetësim serioz për komunitetin e përgjithshëm. Poashtu edhe rezultatet e Anovës mbi përdorimin e alkoolit sipas moshës kur kanë filluar ta përdorin na tregojnë se nuk ka ndonjë dallim signifikantë $p > 0.05$.

Fjalët kyçe: substancë psikotropike, alkool, drogë, stimulantë, depresantë, halucinogjenë

FALËNDERIMI

Falënderoj familjen time, veçanarisht prindërit për mirëkuptimin dhe përkrahjen që më kanë ofruar gjatë këtyre viteve të studimit. Falë ndihmës dhe përkushtimit të tyre, unë kam arritur me sukses rrugëtimin tim profesional.

Poashtu falënderoj edhe mentorin tim Prof. Gani Halilaj që tregoi gatishmëri dhe përkushtim për të më ndihmuar me këshillat dhe udhëzimet e tij për të arritur në përfundim të këtij punimi.

PËRMBAJTJA

ABSTRAKTI	III
FALËNDERIMI	IV
PËRMBAJTJA	V
LISTA E FIGURAVE	VI
FJALORI I TERMAVE	VII
1.HYRJJE	1
2.SHQYRTIMI I LITERATURËS	2
2.1 Drogat dhe klasifikimet e tyre	2
2.1.2 Stimulantët	3
2.1.3 Haluçinogjenet	5
2.1.4 Abuzimi me substanca psikotrope –Droga te personat mbi moshën 20 vjeçare	6
2.2 Alkooli	7
2.2.1 Efektet e Alkoolit	7
2.2.2 Abuzimi me substanca psikotrope –Alkooli te personat mbi moshën 20 vjeçare ..	8
3.DEKLARIMI I PROBLEMIT	10
4.METODOLOGJIA	11
5.PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE	12
6.KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	16
REFERENCAT	17
SHTOJCA	19

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. <i>Depresantë të ndryshëm</i>	3
Figura 2 <i>Stimulantë i lehtë- Nikotina (duhani)</i>	4
Figura 3. <i>Stimulantë i forte –Kokaina</i>	5

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. <i>Analiza Deskriptive e Gjinisë dhe Moshës</i>	12
Tabela 2. <i>Analiza Deskriptive për Statusin Aktual të Pjesëmarrësve</i>	12
Tabela 3. <i>Të dhënat Përshkruese rreth Moshës Aktualte të Pjesëmarrësve</i>	12
Tabela 4. <i>Analiza Deskriptive rreth Problemit të Drogës</i>	13
Tabela 5. <i>Analiza Deskriptive rreth Shqetësimit të Përdorimit të Formave të Ndryshme të Drogës</i>	13
Tabela 6. <i>Analiza Korrelacionare sipas Spearman</i>	14
Tabela 7. <i>Anova mbi Përdorimin e ALkoolit sipas Moshës kur kanë Filluar ta përdorin</i>	14
Tabela 8. <i>Analiza e Regresionit Linear</i>	14

FJALORI I TERMAVE

APA Shoqata Psikologjike Amerikane

ISHP Instituti i Shëndetit Publik

LSD Acidi lisergjik dietilamindë

NCADD Këshilli Kombëtar për varësinë e alkoolit dhe ilaçeve

GBH Gama-hidroksibutrat

PCP Phencyclidina

OBSH Organizata Botërore e Shëndetit

1. HYRJE

Shumica e të rinjëve për shkak të arsyeve të ndryshme fillojnë të përdorin substanca të ndryshme me të cilat abuzohen në forma të ndryshme dhe të cilat kanë ndikim tek këta individ si në aspektin fizik po edhe në atë psikik. Një ndër abuzimet më të shpeshta është edhe abuzimi me substanca psikotrope. Sipas Institutit Nacional për Kancer substancat psikotrope janë një ilaç ose një substancë që ndikon në mënyrën e funksionimit të trurit dhe shkakton ndryshime në humor, vetëdije, mendime, ndjenja si dhe në sjellje. Këto substanca ndryshe mund të quhen edhe substanca psikoaktive .

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetit substancat psikoaktive janë substanca që, kur futen ose administrohen në sistemin e një personi, ndikojnë në proceset mendore, p.sh. njohja ose ndikimi. "Psikoaktiv" nuk nënkupton domosdoshmërisht prodhimin e varësisë, dhe në përgjithësi, termi shpesh lihet i paqartë, si në "përdorimin e drogës" ose "abuzimin me substancat" (OBSH).

Ekzistojnë shumë substanca psikotropike mirëpo me të njohurat dhe më të përdorura nga të rinjtë janë droga dhe alkooli. Në nivel global dhe madje edhe rajonal, droga dhe abuzimi me substancat është një problem gjithnjë e në zgjerim dhe njihet si kërcënim me të efekte serioze në shëndetin, sigurinë, mirëqenien sociale-ekonomike dhe kulturore të njerëzve.

Termi drog është përcaktuar si çdo substancë që zhytet në një organizëm të gjallë dhe mund të modifikojë një ose më shumë nga funksionet e tij fiziologjike. Termi është përdorur përgjithësisht në referencë për një substancë të marrë si për qëllime terapeutike ashtu edhe për substanca të abuzuara. (Kwamanga, Odhiambo & Amukoye, 2003). Varësia e drogës është një sëmundje kronike, relapsuese e trurit që karakterizohet nga ilaç i detyrueshëm kërkimi dhe përdorimi, megjithë pasojat e dëmshme (Instituti Kombëtar mbi Abuzimin e Drogës, 2014).

Abuzimi me alkoolin përfshin një spektër sjelljesh jo të shëndetshme të pirjes së alkoolit, duke filluar nga pirja e duhanit deri tek varësia e alkoolit, në raste ekstreme që rezultojnë në probleme shëndetësore për individët dhe probleme të mëdha sociale, siç janë krimet që lidhen me alkoolin (APA, 2013)

Sipas APA (2013) abuzimi i alkoolit ishte një diagnozë psikiatrike në DSM-IV, dhe është bashkuar me varësinë e alkoolit në çrregullimin e përdorimit të alkoolit.

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Të dhënat më të hershme, të shkruara për substancat narkotike i hasim në tabelat e Sumerit(4000-3000 vjet para erës së re), ku përmendet hashashi, ndërsa në pllakat argjili të zbuluara nëNepur vërehen edhe receta mjekësore. Ndërsa sipas Jones (2011) ,fjala "drog " është me siguri me origjinë arabe dhe së pari u shfaq tek gjermanishtja e vjetër si drog, duke iu referuar një lloj pluhuri.

Hipokrati i konsideruar si babai i mjekësisë (460-377 para erës së re), parapëlqente hashashin për shërimin e sëmundjeve të ndryshme dhe për pagjumësinë. Popujt që jetojnë në Amerikën Jugore, në Ande, ku rritet bima Erytrocion Coca, prej mijëra vjetësh përtpynin gjethet e kësaj bime, që i ndihmonte për të përballuar mundime të mëdha fizike, urinë, etjen dhe përgjithësisht për të përballuar vështirësitë e jetës.

Sipas Institutit të Shëndetit Publik në shoqërinë shqiptare drogat dhe problemet që shkaktojnë ato janë bërë më shumë evidente sidomos pas viteve 90. Me hapjen e shoqërisë, lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave një produkt i ri deri diku edhe i panjohur për shoqërinë tonë të asaj kohe siç ishte droga u fut në vendin tone.

Ndërsa në Evropë droga fillon të përdoret në fillim të shekullit XIX. Evropa e shekullit XIX kishte mjaft të dhëna për drogat, në veçanti për opiumin dhe kanabisin, që përdorehin në mjediset intelektuale dhe aristokratike.

2.1 Drogat dhe klasifikimet e tyre

Sipas OBSH-së me drogë abuzive kuptojmë çfarëdo substancë, e marrë në cilëndo formë të mundshme turbullon humorin, nivelin e perceptimit dhe funksionin cerebral. Sipas këtij përkufizimi merren parasysh drogat e ligjshme, si duhani apo alkooli, si dhe ato të paligjshmet: hashishi, heroina, kokaina, drogat sintetike, etj.

Abuzimi me droga"- nënkupton përdorimin e substancave psiko-aktive dhe abuzimi me to mund të çoj në sindromën e varësisë, ndryshim në sjellje kognitive dhe fenomene fiziologjike të cilat zgjojnë dëshirën për të ripërdorur vazhdimisht, pavarësisht pasojave të dëmshme (Jickells, Negrusz, 2018)

Sipas Institutit të Shëndetit Publik (2011) drogat mund të klasifikohen si

- Depresanët
- Stimulantët
- Haluçinogjenet

2.1.1 Depresantët

Sipas Health Matters drogat depressive, i referohen një numri të madh të kimikateve të njohura, të përdorura gjerësisht. Ato janë përshkruar gjithashtu si hipnotikë qetësues.

Ndonjëherë, disa nga këto ilaçe janë të përshkruara për qëllime mjekësore, por shumë njerëzit i përdorin ato në mënyrë rekreative për t'u "çlodhur", "i qetë".



Figura 1. Depresantë të ndryshëm. (Marrë nga : <https://www.google.com/search?q=droga&tbm=isch&hl=en&tbs=rimg:CZ6Rj9Nlf2l sYRyqXM4s4kIS&sa=X&ved=0CBwQuIIBahcKEwiwlZKn6e7uAhUAAAAAHQAAAA AOBw&biw=1349&b>).

Health Matters depresantët i klasifikon në disa lloje:

- Alkooli
- Marjuana
- Benzodiazepinat (Valium, Serepax, Mogadon, Norismon)
- Barbitudet
- GBH (Gama-hidroksibutrat)
- Opiatet (heroina, morfinakodeina, metadoni, petidina)
- Inhilantet

Ndërsa sipas Institutit Publik (2011) depresantët që përdoren më shumë nga të rinjtë janë alkooli dhe marijuana.

2.1.2 Stimulantët

Sipas Agjensisë Publike të Shëndetit (2013) një stimulues është një ilaç që shpejton sistemi nervor qendrorë për të rritur aktivitetin nervor në trurit. Stimuluesit kanë tendencë t'i bëjnë njerëzit të ndjehen më vigjilent dhe zgjuar, dhe mund të prodhojë

ndjenja euforie. Shumë substanca të reja psikoaktive (ndonjëherë të quajtur "ngritje juridike") përmbajnë ilaçe stimuluese, zakonisht në formë pluhuri, kapsule ose pilule. Marrja e sasive të mëdha të stimulatëve shkakton ankth, panik, kriza, dhimbje koke, dhimbje në stomak, agresivitet dhe paranojë. Stimulantët e fortë mund të maskojnë disa nga efektet e depresantëve si për shëmbull alkooli (Instituti i Shëndetit Publik, 2011).

Stimulantët ndahen në stiumulantë të fortë dhe të lehtë (ISHP, 2011)

Stimulantët e lehtë:

- Kafeina(në çaj,kafe dhe pijet kola)
- Nikotina(duhani)
- Efedrina(përdoret në mjekimet për astëm dhe alergji)

Stimulantët e fortë:

- Amfitemina
- Kokaina
- Ekstazi
- Tabletat dobësuese



Figura 2. Stimulantë i lehtë- Nikotina (duhani). (Marrë nga : <https://www.google.com/search?q=stop+duhanit+alkoolit+dhe+droges&tbm=isch&hl=en&sa=X&ved=2ahUKEwj2wMqk6u7uAhUG2xoKHTBIANQOrNwCKAJ6BQgBEJoB&biw=1349&bih=65>).



Figura 3. *Stimulantë i forte –Kokaina* (Marrë nga: https://www.google.com/search?q=kokaina+&tbm=isch&ved=2ahUKEwjzqfaC6-7uAhXH-qOKHfMAAksQ2-cCegQIABAA&oq=kokaina+&gs_lcp=CgNpbWcQAzICCAAvAggAMgIIADICCAAvAgg).

2.1.3 Haluçinogjenet

Halucinogjenët janë një nga klasat më të vjetra të ilaçeve të përdorura nga njerëzimi. Sipas Institutit Kombëtarë të Familjes mbi abuzimin e drogës (1966) halucinogjenët janë i dyti ilaç i paligjshëm që përdoret më shpesh në Shtetet e Bashkuara pas marihuanës, me 10% të popullsisë së rritur (rreth 2.1 milion njerëz) pasi i kanë provuar të paktën një here.

Sipas Institutit Nacional mbi Abuzimin e drogës (2019) halucinogjenët janë një grup i larmishëm ilaçesh që ndryshojnë ndërgjegjësimin e një personi për të rrethinë si dhe mendimet dhe ndjenjat e tyre. Ndër llojet më të njohura janë: PCP (phencyclidina) dhe LSD-ja (acidi lisergjik dietilamindë ose thjesht acidi)

Drogat haluçinogjene shndërrojnë mënyrën se si një person sheh ose imagjinon atë që e rrethon (ISHP, 2011).

Llojet kryesore të haluçinogjenëve janë:

- Datura (bimë)
- Katemina
- LCD (acid dietilmid)
- Këpurdat magjike

- Meskalina
- PCP
- Marjuana
- Ekstazi
-

2.1.4 Abuzimi me substanca psikotrope –Droga te personat mbi moshën 20 vjeçare

Abuzim droge quhet kur substancat e kontrolluara përdoren në një mënyrë ose në shumë më të madhe kundërshtim me përdorimin e ligjshëm mjekësor.(Abuse, 2017). Personat që përdorin substanca janë kryesisht të rinj, duke filluar midis 16 dhe 25 vjeç, ku shpeshëherë shfaqja e kësaj sjelljeje mund të ndodhë edhe më herët, dhe madje para moshës 14 vjeç.(Rotemberg, Salveraglio, Piovesán, Almaráz, Ferreira, Smaisik & Mazzuco, 2019).

Raporti Botëror UNODC i Drogës i vitit 2009 tregoi se shumica e njerëzve filluan të përdorin drogën në rininë e tyre.

Të rinjtë mund të përgjigjen ndaj ndryshimeve të drogës disponueshmëria ose perceptimi shoqëror i konsumit për një shtrirje më e madhe se të rriturit. Përveç kësaj, fillimi i hershëm e konsumit rrit rrezikun e negative sociale dhe pasojat shëndetësore së bashku me një rrezik të rritur të kryerjes së krimeve ose krimin në ndikimin e droga ose për të marrë para për t'i blerë ato. Në një hulumtim të kryer në qendrën e rehabilitimit në e Portal Amari u gjetë se substancat më të përdorura nga të rinjtë mbi moshën 20 vjeçare ishin marihuana dhe kokaina, të ndjekura nga hidroklorur kokainë, alkooli , nikotina, halucinogjenet, ilaçet psikoaktive dhe "bazuco" (një lloj të pastës së papërpunuar të kokainës).

Individët tek të cilët prindërit ose anëtarët e tjerë të familjes i kanë përdorin substancat psikoaktive, prirjen të fillojnë më herët përdorimin e substancave psikoaktive si dhe të vazhdojnë abuzimin edhe për një kohë më të gjatë (Bancroft e të tjerë ., 2004; Obot e të tjerë ., 2001; Repetti e të tjerë., 2002).

Shumë të rinj janë të përfshirë në abuzimin me substance psikotropike për shkak të varfërisë së madhe (Rotemberg, Salveraglio, Piovesán, Almaráz, Ferreira, Smaisik & Mazzuco, 2019). Poashtu Rotemberg, Salveraglio, Piovesán, Almaráz, Ferreira, Smaisik & Mazzuco (2019) vazhdojnë se të rinjtë e prekur nga varfëria ose në grupe të tjera të rrezikuara, siç janë emigrantët, mund të rekrutohen nga grupet e krimin të

organizuar dhe të detyruar të punojnë në kultivimin e drogës, prodhimin, trafikimin dhe marrëveshje të nivelit lokal.

2.2 Alkooli

Alkooli i cili është përcaktuar më së miri nga Këshilli Kombëtar për varësinë e alkoolit dhe ilaçeve (NCADD) dhe Shoqata Amerikane e Mjekësisë së Varësisë (1992) si "një sëmundje parësore, kronike me faktorë gjenetikë, psikosocialë dhe mjedisorë që ndikojnë në zhvillimin dhe manifestimet e saj (Mansour, 2016). Konsumi i alkoolit renditet si i pesti faktor i rëndësishëm rreziku për barrën e sëmundjes në të gjithë botën (Lim e të tjerë ., 2012; Rehm e të tjerë., 2003b; Organizata Botërore e Shëndetit, 2014) dhe u rendit e para në rajonin e Amerikës për vitin 2004 (Rehm dhe Monteiro, 2005). Konsumi i përgjithshëm ka të bëjë me vdekshmëri gjithëpërfshirëse dhe vdekshmëri dhe paaftësi specifike për alkoolin (Edwards e të tjerë, 1994); prandaj, ndryshimet në konsumin çojnë në ndryshime në ngarkesën e përgjithshme si dhe në sëmundjen specifike të alkoolit në një popullatë.

Ekzistojnë tre dimensione të konsumit të alkoolit: vëllimi mesatar i konsumit, modelet e pirjes dhe, në disa raste, gjithashtu cilësia e alkoolit të konsumuar, të gjitha kanë të bëjnë me barrën e sëmundjes që i atribuohet konsumimit të alkoolit (Rehm e të tjerë., 2003a, 2010a; Organizata Botërore e Shëndetit, 2010). Vëllimi mesatar i alkoolit i konsumuar nga një person është i lidhur kryesisht për pasoja shëndetësore afatgjata, përfshirë varësinë nga alkooli. Megjithatë vëllimi mesatar është i lidhur edhe me ishemike sëmundje të zemrës, goditje ishemike dhe lëndime (Rehm e të tjerë , 2010b; Roerecke dhe Rehm, 2010; Taylor e të tjerë, 2010), disa studime tregojnë se aftësia për të parashikuar sëmundje të tilla ishemike dhe lëndime është rritur duke marrë parasysh modelet e pirjes (MacDonald e të tjerë., 2013; Rehm e të tjerë, 1996)

Sipas raportit të Institutit Kombëtar për Abuzimin me Alkoolin dhe Alkoolizmi, në një vit, problemi i lidhur me alkoolin i merr jetën nga rreth 88,000 njerëz.

2.2.1 Efektet e Alkoolit

Përveç që është një ilaç i varësisë, alkooli njihet për shumë vite si shkak i rreth 60 lloje të ndryshme të sëmundjes dhe gjendjes, përfshirë dëmtimet, mendore dhe të sjelljes çrregullime, gjendje gastrointestinale, kancere, sëmundje kardiovaskulare, çrregullime imunologjike, sëmundjet e mushkërive, sëmundjet skeletore dhe muskulore,

çrregullimet riprodhuese dhe dëmet para lindjes, përfshirë një rrezik të rritur të parakohshmërisë dhe peshës së ulët të lindjes (Anderson & Baumberg, 2006).

Në vitin 2007, Agjensia Ndërkombëtare për Kërkime mbi Kancerin arriti në përfundimin se ekziston një lidhje shkakësore midis alkoolit dhe kancerit të zgvërës me gojë, faringut, laringut, ezofagut, mëlçisë, zorrës së trashë, rektumit dhe gjoksi femëror (Baan e të tjerë ., 2007; IARC, 2010).

Përdorimi i alkoolit është i lidhur jashtëzakonisht shumë në mënyrë të dëmshme me shumë rezultate kardiovaskulare, përfshirë sëmundjen hipertensionale (Taylor e të tjerë, 2009), goditje hemorragjike (Patra e të tjerë 2010) dhe fibrilacioni atrial (Samokhvalov, Irving & Rehm, 2010).

Karam et al. (2008) sugjeroi një marrëdhënie ekzistuese midis përdorimit të alkoolit dhe niveleve të ankthit. Pirja në nivele të rrezikshme rrit rrezikun e hipertensionit (Chermack, e të tjerë , 1996; Instituti Kombëtar) e Alkolizmit dhe Abuzimit me Alkoolin, 1995) dhe mund rrisin rrezikun e kancerit të gjirit (Baker, 1985; Rosin dhe Glatt, 1971) dhe diabeti (Vestal et al., 1977). Blow dhe kolegët e tij (2000) gjetën efekte negative të statusit të pirjes së alkoolit në përgjithësi në shëndet, funksionim fizik, dhimbje,, shëndetin mendorë, rolin emocional dhe funksionimin shoqëror.

Problemet që lidhen me alkoolin mund të ndahen në problemet e shkaktuara nga raste individuale të pirjes dhe ato për shkak të konsumit të zgjatur. Intoksikimi dobëson në mënyrë akute aftësinë për të menduar, vëzhguar dhe reaguat dhe zvogëlon frenimet dhe gjykimin dhe kjo mund të çojë në situata të rrezikshme si seksi i pambrojtur, sjellja e rrezikshme e sjelljes lëndime, duke u dhunuar ose sulmuar, dhe duke kryer krime të ndryshme (Mäkelä e të tjerë 2010).

2.2.2 Abuzimi me substanca psikotrope –Alkooli te personat mbi moshën 20 vjeçare

Keqpërdorimi i substancave psikotrope (përdorimi në sasi më të mëdha,ose edhe më shpesh sesa të përshkruara) me përdorimin të alkoolit tani shihet si një problem në rritje në mbarë botën (Agjensia për Hulumtime dhe Cilësi të Shëndetit, 2010).

Të rinjtë mbi moshën 20 vjeçare kanë shumë më shumë gjasa të vuajnë fizikisht, mendërisht dhe shoqërisht nga efektet e alkoolit (Kiianmaa, Hyytiä & Partonen 2007 9-11; Mäkelä e të tjerë 2010, 15, 66-67).

Kylmänen (2005, 23) ndan përdorimin e alkoolit të të rinjve si më poshtë

1. Abstenimi
2. Përdorimi eksperimental

3. Përdorimi i rastit

4. Përdorimi i hershëm shqetësues ose i dëmshëm

5. Përdorim i dëmshëm (abuzim i shpeshtë dhe i rregullt i substancave, shpesh me pasoja të dëmshme)

6. Vartësia e substancave

Parandalimi i abuzimit të substancave ka disa nivele, duke zvogëluar dhe parandaluar fillimin e përdorimit të substancave dhe kufizimi i zhvillimit të problemeve që lidhen me të, të tilla si sëmundja (Kylmänen, 2005, 13)

Problemet me alkoolin kanë një larmi rrënjësh, disa prej tyre kërkojnë terapi profesionale dhe udhëzimi. Sidoqoftë, këshillat për çështje të së kaluarës nuk janë efektive për ndryshimin e alkoolit, por mund të pasojnë ndërhyrjen e alkoolit (Korhonen, 2004).

Përafërsisht 30% e individëve meshkuj dhe 50% e individëve femra që karakterizohen me konsumim të lartë alkoolit vuajnë nga depresioni i rëndë në periudha më të gjata (Brown dhe Schuckit, 1988).

Në një hulumtim UNICEF, WHO dhe UNFPA (2019) raportojnë se nga totali prej 37.8% i të rinjëve raportuan të kenë konsumuar ndonjëherë alkoolin (47.8% e grupmoshës 20 -24 kanë përdorur alkoolin gjatë jetës së tyre krahasuar me 30.6% të rinjtë e grupmoshës 15-19). Të rinjtë meshkuj kishin gjasa më të mëdha të kenë konsumuar ndonjëherë alkoolin sesa të rejtat femra (45.2% krahasuar me 30.5%).

Shumica e të rinjëve nga Kosova zakonisht blejnë/konsumojnë alkoolin nëpër kafeteri apo diskoteka (58.2%). Një e pesta e respondentëve zakonisht konsumojnë alkoolin nëpër ahengje (19.5), ndërsa një e dhjeta e respondentëve raportuan të kenë blerë alkoolin në minimarkete (10.8%), shifër identike me të rinjtë, që zakonisht e konsumuan alkoolin në shtëpitë e tyre (10.8%) (UNICEF, WHO dhe UNFPA, 2019).

Të rinjtë meshkuj kishin gjasa më të mëdha sesa të rejtat-femra të kenë konsumuar alkoolin nëpër kafeteri e diskoteka (62.7%), krahasuar me të rinjtë nëpër tregje/minimarkete (13.2%), ndërsa shumica e të rinjëve femra konsumojnë alkoolin nëpër ahengje (24.2%) dhe shtëpi. (UNICEF, WHO dhe UNFPA, 2019).

Në këtë anketë, 3.5% e të rinjëve kanë menduar në një çast të jetës së tyre të bëjnë vetëvrasje. Kjo ishte më e shprehur në mesin e të rinjëve të moshës 20 - 24 vjeç. Lidhur me të menduarit për vetëvrasje, nuk kishte dallime domethënëse statistikore ndërmjet të meshkujve dhe të femrave apo në mes të rinjëve të etniteteve të ndryshme. (UNICEF, WHO dhe UNFPA, 2019).

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Problemet sociale apo familjare, që individët përjetojnë pastaj edhe divorcet e prindërve, papunësia e shumë faktorë të tjerë që ndikojnë që bota e të rinjëve të reduktohet gjithnjëe më shumë tek alkooli dhe droga, të cilët me ndikimin që kanë arrijnë që për një kohë abuzuesit e këtyre substancave t'i harrojnë problemet që kanë. Prandaj edhe një nga sfidat më të mëdha të shoqërisë njerëzore është parandalimi i numrit të vetëvrasjeve që vie si shkak i përdorimit të madh të alkoolit dhe drogës.

Sipas Institutit të Shëndetit Publik (2011) problemi i pirjes së alkoolit, që shprehet në marrjen e përsëritur të tij, konsiderohet nga shumë mjekë si një mjet për të lehtësuar anthin dhe si një zgjidhje e problemeve të tyre emocionale.

Duke patur një histori familje me abuzim substancash e pozicionon një fëmijë në rrezik për abuzim droge. Megjithatë, në një mjedis me bashkëmoshatarë jo abuzues me drogën, i riu ka më pak mundësi të bëhet një abuzues droge (ISHP, 2011).

4. METODOLOGJIA

Qëllimi i studimit

Qëllimi i këtij studimi është të shohim më shumë rreth abuzimit të substancave subtropike-droga dhe alkooli dhe ndikimin e këtyre substancave tek personat mbi moshën 20 vjeçare.

Hipotezat e këtij studimi janë:

H1: Kur njerëzit flasin për "një problem të drogës", është droga e parë që mendojnë njerëzit është marijuana/kanabisi.

H2: Statusi familjar nuk ndikon në fillimin e përdorimit të drogës.

Mostra

Popullata e këtij studimi janë të rinjtë e moshës mbi 20 vjeçare, që përkasin vendbanime të ndryshme për arsye që edhe pyetësi është shpërndarë në formën elektronike. Gjithsej ishin 85 pjesëmarrës që shumica i përkasin gjinisë

Metodat

Për mbledhjen e të dhënave është përdorur pyetësi dhe anketa në formën elektronike, ku anketa ishte rreth drogës që kishte gjithsej 14 pyetje të mbyllura, ndërsa pyetësi që është përdorur është pyetësi i Sondazhit Kombëtar i Familjeve për Strategjinë e Barnave 2016, ku janë marrur vetëm pyetjet që më janë duhur.

Duke u bazuar në metodologjinë që është përdorur në këtë punim, rezultojmë se ky punim ka qasje kuantitative

Procedurat

Ky studim është realizuar gjatë muajit Gusht ku të dhënat janë mbledhur gjatë këtij muajit.

Të gjithë pjesëmarrësit gjatë këtij procesit të hulumtimit janë respektuar sa i përket të dhënave të tyre personale, ku të dhënat e pjesëmarrësve janë përdorur vetëm për qëllime të hulumtimit dhe për asnjë qëllim tjetër nuk janë shfrytëzuar, ku secilit pjesëmarrës iu është ruajtur anonimiteti.

5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE

Në këtë studim me anë të mbledhjes së të dhënave në mënyrë elektronike kemi arritur tek rezultatet që do të prezantohen në vazhdim.

Tabela 1. *Analiza Deskriptive e Gjinisë dhe Moshës*

	N	%
Gjinia		
Femër	55	64.7
Mashkull	30	35.3
Mosha		
20	22	25.9
21	21	24.7
22	6	7
23	4	3.6
24	10	11.8
25	25	27

Në bazë të analizës deksriptive shohim se numri i pjesëmarrësve gjithsej ishte 85 dhe se numri më i madh i pjesëmarrësve i përket gjinis femërore (N=55, 64.7%) ndërsa sa i përket moshës së pjesëmarrësve në këtë studim shohim se 27% e pjesë marrësve i përkasin moshës 25, pastaj 25.9% i përkasin moshës 20 vjeç e kështu më rradhë.

Tabela 2. *Analiza Deskriptive për Statusin Aktual të Pjesëmarrësve*

	N	%
Cila nga të mëposhtmet përshkruan më së miri statusi aktual të tuajin?(Shënoni vetëm një përgjigje)		
Asnjëherë i martuar	6	7.1
Beqar	71	83.5
I/ e martuar	8	9.4

Nga tabela deskriptive shohim se 7.1% e pjesëmarrësve nuk kanë qenë asnjëherë të martuar, pastaj 83.5% janë beqar si dhe 9.4% të pjesëmarrësve janë të martuar .

Tabela 3. *Të dhënat Përshkruese rreth Moshës Aktualte të Pjesëmarrësve.*

	SD	MA	Min.	Max.
Cila është mosha aktuale e juaja ?	1.822	20.06	16	25

Nga tabela e 3 shohim se mesatarja aritmetike e moshës së pjesëmarrësve është 20 vjeç kurse pjesëmarrësit me moshë më të madhe i takojnë moshës 25 vjeç.

Tabela 4. *Analiza Deskriptive rreth Problemit të Drogës*

	N	%
Kur njerëzit flasin për "një problem të drogës", cila është droga e parë që mendoni?		
Alkool	13	15.3
Duhani	2	2.4
Heroina	11	12.9
Marijuana / Kanabisi	49	57.6
Metodologjia / amfetaminë	1	1.2
Droga të tjera	5	5.9
Asnjëra nga këto	4	4.7

Në bazë të analizës deskriptive për: Kur njerëzit flasin për "një problem të drogës", cila është droga e parë që mendoni? shohim se pjesa më e madhe e pjesëmarrësve pra 57.6% prej tyre mendojnë se bëhet fjalë për marijuana/kanabisi, pastaj 15.3% mendojnë për alkoolin kurse vetëm 1.2% prej tyre mendojnë se është metodologjia/amfetamina.

Tabela 5. *Analiza Deskriptive rreth Shqetësimit të Përdorimit të Formave të Ndryshme të Drogës*

	N	%
Cila prej këtyre formave të përdorimit të drogës ju bënë juve të mendoni se është shqetësimi më serioz për komunitetin e përgjithshëm? (Shënoni vetëm një përgjigje)		
Pirja e tepërt e alkoolit	14	16.5
Heroina	19	22.4
Kokainë	18	21.2
Marijuana / Kanabisi	24	28.2
Pirja e duhanit	4	4.7
Përdorimi jo-mjekësor i Meth / amfetaminë	3	3.5
Ekstazë	2	2.4
Asnjëra nga këto	1	1.2

Nga tabela deskriptive shohim se 28.2% e pjesëmarrësve mendojnë se marijuana është shqetësimi më serioz për komunitetin e përgjithshëm, pastaj 22.4% prej tyre mendojnë se alkooli është një shqetësim, kurse vetëm 1.2% e pjesëmarrësve mendojnë se asnjëra nga këto nuk paraqesin ndonjë shqetësim serioz për komunitetin e përgjithshëm.

Tabela 6. *Analiza Korrelacionare sipas Spearman*

	1	2
1.Në cilën moshë keni qenë kur keni provuar për here të parë alkool ?	-	.517**
2. Nëse keni pirë ndonjë pije alkoolike në 12 muajt e fundit atëherë cila ishte mosha e juaj kur keni pirë ?	.316*	-

Korrelacioni sipas analizës Spirman.* Korrelacioni signifikant në nivelin 0.05(2-talide)

** Korrelacioni signifikant në nivelin 0.01 (2-talide).

Në këtë tabelë është përdorur analiza e korrelacionit të Spearman ku nga tabela shohim se nuk ka dallime signifikante të rëndësisë statistikore në mes këtyre dy variablave,

Tabela 7. *Anova mbi Përdorimin e Alkoolit sipas Moshës kur kanë Filluar ta përdorin.*

	SS	df	MA	F	P
Mes grupeve	25.71	2	12.85	1.63	.20
Brenda grupeve	1004.59	127	7.91		
Totali	1030.30	129			

Rezultatet e Anovës mbi përdorimin e alkoolit sipas moshës kur kanë filluar ta përdorin na tregojnë se nuk ka ndonjë dallim signifikantë $p > 0.05$ në mes këtyre variablave të dhëna në tabelë.

Tabela 8. *Analiza e Regresionit Linear.*

	B	β	t	p
Konstant	22.55		12.45	.000
Cila nga këto kategori sa i përket statusit familjar ju përshkruan juve?	.188	.071	.80	.42

Rezultatet nga regresioni linear paraqesin se kategoria e statusit familjar nuk ndikon në fillimin e përdorimit të drogës $F(1,128) = .652$, $p = .42$ dhe $R = .005$.

Diskutim: Në bazë të analizave të bëra dhe rezultateve të marrura nga këto analiza hipoteza 1: Kur njerëzit flasin për "një problem të drogës", është droga e parë që mendojnë njerëzit është marijuana/kanabisi është vërtetuar. Po ashtu edhe hipoteza 2 që është rreth: Statusi familjar nuk ndikon në fillimin e përdorimit të drogës është vërtetuar.

Poashtu arritëm të shohim se njëri nga problemet më shqetësuese për komunitetin e përgjithshëm të shoqërisë njerëzore është përdorimi i marihuanës dhe heroinës që më të vërtetë përdorimi i këtyre substancave ka një efekt negativ tek rinia e shoqërisë sonë. Sa i përket fillimit të përdorimit të alkoolit poashtu pamë se statusi familjar si të jetuarit vetëm apo me të dy prindërit ose të jetuarit me njërin prind nuk ka ndonjë ndikim tek mosha kur individët fillojnë për konsumimin e alkoolit.

6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkuzionet:

Ky studim na tregoi se problem i abuzimit të drogës dhe alkoolit është një shqetësim serioz për komunitetin e përgjithshëm të shoqërisë njerëzore, ku shumica e të rinjëve përdorimin e këtyre substancave të rinjët e shikojnë si një nga mënyrat për largimin e problemeve. Poashtu pamë se shumica e të rinjëve e konsumojnë alkoolin në festa të ndryshme ku edhe vetë shoqëria është ajo që i ka ofruar pije së pari. Mirëpo pamë se pavarësisht mënyrës së të jetuarit si të jetuarit vetëm apo me ty prindërit ose mënyra tjetër nuk konsiderohet ndonjë faktorë për fillimin e përdorimit të këtyre substancave.

Rekomandimet:

Abuzimi me substanca psikotropike nga të rinjët është mjaft shqetësues prandaj është shumë e nevojshme që të merren masat dhe modele të ndryshme për parandalimin e përdorimit të tyre. Fillimi i përdorimit të alkoolit, duhanit dhe substancave të tjera psikoaktive është një çështje thellësisht sociale, e cila e merr origjinën dhe fuqizohet nga kontaktet sociale. Një ndër masat që mund të ndërmeren është kufizimi i moshës për përdorimin e tyre, pastaj rritja e çmimit të këtyre produkteve, pastaj organizimi i aktiviteteve të ndryshme sociale dhe edukative ku mundësohet përfshirja e të rinjëve. Përveç kësaj është e rëndësishme edhe mbështetja e këtyre personave si në çështjet mësimore, duke organizuar edhe seanca të ndryshme të trajtimit të reduktimit të përdorimit të substancave duke i inkurajuar gjithmonë që të ndërpresinë përdorimin e tyre. Përveç kësaj e dime se edhe shokët apo miqtë janë pjesë e mjedisit social, në të cilin të rinjtë mësojnë se si të përdorin substancat psikoaktive dhe si të sillen pas përdorimit të tyre. Ky ndikim është i dyanshëm pasi që të rinjtë që përdorin substanca psikoaktive zgjidhen të jenë miq me disa persona të tjerë, pikërisht për shkak se ata përdorin këto substanca dhe qëndrimeve që ata kanë ndaj këtyre substancave. Për më tëpër, të rinjtë dhe moshat madhore i zgjedhin miqtë e tyre edhe në bazë të këtyre kriterëve. Prandaj është e rëndësishme që të dime të zgjedhim rrethin shoqëror me të cilët qëndrojmë duke u munduar që çdo here ta kemi një shoqëri sa më të shëndoshë.

REFERENCAT

- Alcohol history.* (n.d.). ResearchGate. Retrieved Gusht 8, 2020, nga https://www.researchgate.net/publication/310589270_Alcohol_history
- Drug abuse among the students.* (n.d.). ResearchGate. https://www.researchgate.net/publication/273924102_Drug_abuse_among_the_students
- Drug Addiction: Current Trends and Management.* (n.d.). ResearchGate. Tërhequr më Korrik,25, 2020, nga https://www.researchgate.net/publication/321244920_Drug_Addiction_Current_Trends_and_Management
- 2007 DRUG USE AND RELATED PROBLEMS AMONG VERY YOUNG PEOPLE (UNDER 15 YEARS OLD).* (n.d.). http://www.drugs.ie/resourcesfiles/ResearchDocs/Europe/Research/2007/TDS_I07001ENC.pdf
- A Guide to Preventing Older Adult Alcohol and Psychoactive Medication Misuse/Abuse: Screening and Brief Interventions.* (n.d.). Tërhequr më Gusht 10 , 2020, nga <https://www.ncoa.org/wp-content/uploads/SBIRT-Older-Adult-Manual-Final.pdf>
- American Psychiatric Association. (2013). *Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders.* <https://doi.org/10.1176/appi.books.9780890425596>
- Anderson, P. (n.d.). *The impact of alcohol on health.* Tërhequr më Gusht, 5, 2020, nga https://www.euro.who.int/_data/assets/pdf_file/0010/191359/1-The-impact-of-alcohol-on-health.pdf?ua=1
- Bonson, K. R. (2001). Hallucinogenic Drugs. *ELS.* <https://doi.org/10.1038/npg.els.0000166>
- Drogat dhe pasojat e përdorimit të saj tek të rinjtë.* (n.d.). http://www.ishp.gov.al/multimedia/botime/broshure_droga.pdf
- Drogat dhe pasojat e përdorimit të saj tek të rinjtë.* (n.d.). Tërhequr me Gusht, 5, 2020, nga http://www.ishp.gov.al/multimedia/botime/broshure_droga.pdf
- Jones, A. W. (2011). Early drug discovery and the rise of pharmaceutical chemistry. *Drug Testing and Analysis*, 3(6), 337–344. <https://doi.org/10.1002/dta.301>
- Knopf, A. (2017). What that DEA law was really about. *Alcoholism & Drug Abuse Weekly*, 29(42), 5–5. <https://doi.org/10.1002/adaw.31756>
- Monteiro, M. G. (2019). OBSOLETE: Alcohol Consumption: Overview of International Trends. *Reference Module in Biomedical Sciences.* <https://doi.org/10.1016/b978-0-12-801238-3.03186-x>
- NCI Dictionary of Cancer Terms - National Cancer Institute.* (2011, February 2). Www.Cancer.Gov. <https://www.cancer.gov/publications/dictionaries/cancer-terms/def/796899#:~:text=A%20drug%20or%20other%20substance>

- Niethammer, O., & Frank, R. (2006). Prevalence of use, abuse and dependence on legal and illegal psychotropic substances in an adolescent inpatient psychiatric population. *European Child & Adolescent Psychiatry*, 16(4), 254–259. <https://doi.org/10.1007/s00787-006-0597-5>
- Niethammer, O., & Frank, R. (2006). Prevalence of use, abuse and dependence on legal and illegal psychotropic substances in an adolescent inpatient psychiatric population. *European Child & Adolescent Psychiatry*, 16(4), 254–259. <https://doi.org/10.1007/s00787-006-0597-5>
- O'Donnell, A., Anderson, P., Newbury-Birch, D., Schulte, B., Schmidt, C., Reimer, J., & Kaner, E. (2013). The Impact of Brief Alcohol Interventions in Primary Healthcare: A Systematic Review of Reviews. *Alcohol and Alcoholism*, 49(1), 66–78. <https://doi.org/10.1093/alcalc/agt170>
- Rotemberg, E., Salveraglio, I., Piovesán, S., Almaráz, M., Ferreira, B., Smaisik, K., & Mazzuco, M. (2020). Perception of oral health status of adolescents and young adults undergoing substance abuse treatment. *Journal of Oral Research*, 8(5), 378–385. <https://doi.org/10.17126/joralres.2019.059>
- Simoni-Wastila, L., & Yang, H. K. (2006). Psychoactive drug abuse in older adults. *The American Journal of Geriatric Pharmacotherapy*, 4(4), 380–394. <https://doi.org/10.1016/j.amjopharm.2006.10.002>
- Tërhequr më Korrik 24 ,2020 nga <https://core.ac.uk/download/pdf/38069912.pdf>
- Tërhequr më Korrik 24 ,2020 nga https://www.unicef.org/kosovo/RAR_Alb.pdf
- What are they? (n.d.). Tërhequr më Korrik 22 2020, nga [https://newscenter.sdsu.edu/student_affairs/healthpromotion/files/03737-Depressant_Drugs_\(06-2013\).pdf](https://newscenter.sdsu.edu/student_affairs/healthpromotion/files/03737-Depressant_Drugs_(06-2013).pdf)
- WHO | Psychoactive substances. (2010). *Who.Int*. https://doi.org/entity/substance_abuse/terminology/psychoactive_substances/en/index.html

SHTOJCA

Të dhënat demografike

Gjinia:

Femër

Mashkull

Cila është mosha aktuale e juaja ? _____

Cila nga të mëposhtmet përshkruan më së miri statusi aktual të tuajin?

(Shënoni vetëm një përgjigje)

- Beqar
- I martuar
- Asnjëherë i martuar
- I/e Ve
- I/e divorcuar

Cila nga këto kategori ju përshkruan juve?

- Jetoj vetëm
- Jetoj me të dy prindërit dhe familjen e ngushtë
- Jetoj me nënën
- Jetoj me babin
- Tjetër

1. Kur njerëzit flasin për "një problem të drogës", cila është droga e parë që mendoni?

- Alkool
- Duhani
- Marijuana / Kanabisi

- Metodologjia / amfetaminë
- Heroina
- Droga të tjera
- Asnjë

2. Cila prej këtyre formave të përdorimit të drogës ju bënë juve të mendoni se është shqetësimi më serioz për komunitetin e përgjithshëm? (Shënoni vetëm një përgjigje)

- Pirja e tepërt e alkoolit
- Pirja e duhanit
- Marijuana / Kanabisi
- Përdorimi jo-mjekësor i Meth / amfetaminë
- Kokainë
- Ekstazë
- Heroina
- Asnjëra nga këto

3. Për secilën nga ilaçet e listuara më poshtë, e miratoni ose nuk e pranoni personalisht përdorimin e tyre të rregullt nga një i rritur?

	E miratoj fort	Miratoj	As nuk e miratoj as nuk e kundërshtoj	Nuk e miratoj	Fort nuk e miratoj	Nuk e di se çfarë të them..
Alkooli						
Duhani						
Përdorimi jo-mjekësor I qetësuesve dhe barnave të gjumit						

Marihuana/Kana

bisi

Halucinogjenët

Përdorimi jo-

mjekësor i

Metadonit /

Buprenorphine

Përdorimi jo-

mjekësor i Meth /

amfetaminë

Heroina

Kokaina

GHB

Ketamina

4. A e keni provuar ndonjëherë alkoolin ? PO JO
5. Në cilën moshë keni qenë kur keni provuar për here të parë alkool ?

6. Kush ishte personi i parë që ju ofroi gotën e parë të alkoolit?
- Shoqëria
 - Vëllau/Motra
 - Prindërit
 - Të afërmit e tjerë
 - Nuk e kujtoj
7. A keni pirë ndonjë pije alkoolike të çfardo lloji në 12 muajt e fundit të vitit ?
PO JO
8. Nëse keni pirë në 12 muajt e fundit ndonjë pije alkoolike, atëher cila ishte mosha e juaj kur keni pirë ? _____
9. Në 12 muajt e fundit të vitit sa shpesh keni pirë pije alkoolike? (Shënoni vetëm një përgjigje)
- Çdo ditë
 - 5 deri në 6 ditë në javë
 - 3 deri 4 ditë në javë

- 1 deri në 2 ditë në javë
- 2 deri në 3 ditë në muaj
- Rreth 1 ditë në muaj
- Më rrallë
- Nuk pi më

10. Cila është pija alkoolike që përdoni më së shpeshti ? (Shënoni vetëm një)

11. Në 12 muajt e fundit a keni ndryshuar pijen tuaj alkoolike? Po Jo

12. Cili lloj i alkoolit më parë ishte pija juaj kryesore? (Shënoni vetëm një përgjigje)

- Verë e thekur
- Verë në shishe
- Birrë me forcë të rregullt (më e madhe se 4% Alc / Vol)
- Birrë me forcë të mesme (3% deri 3.9% Alc / Vol)
- Birrë me alkool të ulët (1% deri 2.9% Alc / Vol)
- Birrë në shtëpi
- Verë e fortifikuar
- Pije të tjera të para-përzieria (p.sh. birrë dhe verë me bazë)
- tjetër

13. Në cilin vend më së shumti konsumoni alkoolin më së shumti ?

- Në shtëpia ime
- Në shtëpinë e një miku
- Në një festë në shtëpinë e dikujt
- Në restorante / kafene
- Në ambientet e licencuara (p.sh. pijet, klubet)
- Në Shkollë, TAFE, Universitet, etj.
- Në vendin tim të punës
- Në vendet publike (p.sh. parqe, plazhe)
- Në një makinë apo automjet tjetër
- Diku tjetër

14. Në 12 muajt e fundit a keni ju. . .? (Shënoni të gjitha ato që vlejné)

- Ulur sasinë e alkoolit
- pini në çdo kohë
- Ulur numrin e herëve që pini
- Kaloi në pirjen më pak të alkoolit
- pije sesa dikur
- Ndaluar pirjen e alkoolit
- Ndryshoi pijen tuaj kryesore
- Asnjë nga këto

15. Në një ditë që ju keni një pije alkoolike, sa pije standarde keni zakonisht?
(Shënoni vetëm një përgjigje)

- 9 - 10 pije
- 7 - 8 pije
- 5 - 6 pije
- 3 - 4 pije
- 20 ose më shumë pije
- 16 - 19 pije
- 13 - 15 pije
- 11 - 12 pije
- 2 pije
- 1 pije
- Gjysmë pije

16. Në 12 muajt e fundit, sa shpesh keni dështuar për të bërë atë që normalisht pritej nga ju (Shënoni vetëm një përgjigje)

- Çdo ditë
- 5 deri në 6 ditë në javë
- 3 deri 4 ditë në javë
- 1 deri në 2 ditë në javë
- 2 deri në 3 ditë në muaj
- Rreth 1 ditë në muaj
- Më rrallë por të paktën një herë

- Kurrë
17. Në 12 muajt e fundit, sa shpesh keni pasur një ndjenjë faji apo pendimi pas pirjes? (Shënoni vetëm një përgjigje)
- Çdo ditë
 - 5 deri në 6 ditë në javë
 - 3 deri 4 ditë në javë
 - 1 deri në 2 ditë në javë
 - 2 deri në 3 ditë në muaj
 - Rreth 1 ditë në muaj
 - Më rrallë por të paktën një herë
 - Kurrë
18. A jeni plagosur ju, ose dikush tjetër, për shkak të pirjes suaj (Shënoni vetëm një përgjigje)
- Po, në 12 muajt e fundit
 - Po, por jo në 12 muajt e fundit
 - Jo
19. Në kohën e tanishme e konsideroni veten. . (Shënoni vetëm një përgjigje)
- Një jo pijanec
 - Një ish-pijanec
 - Një pijanec i rastit
 - Një pijanec i/e lehtë
 - Një pijanec socialë
20. Sa e dëmshme apo e dobishme mendoni se konsumi i alkoolit, duke përfshirë mos pirjen e asnjë alkooli, a është për shëndetin tuaj? (Shënoni vetëm një përgjigje)
- Shumë e dëmshme
 - Disi i dëmshëm
 - As e dëmshme dhe as e dobishme
 - Disi i dobishëm
 - Shumë e dobishme
 - Nuk e di

21. Në 4 javët e kaluara, për sa shpesh keni qene nervoz? (Shënoni vetëm një përgjigje)
- Asnjëhere
 - Pak kohë
 - Disa nga koha
 - Shumicen e kohes
 - Gjatë gjithë kohës
22. Në 4 javët e kaluara, për sa shpesh keni qene i depresionuar? (Shënoni vetëm një përgjigje)
- Asnjëhere
 - Pak
 - Shumicen e kohes
 - Gjatë gjithë kohës

Pyetesori per Drogë

Sipas mendimit tënd, sa është droga e rrezikshme?

a) Nuk është e dëmshme. b) Pak e dëmshme. c) E dëmshme. d) Nuk e di.

2. Sa lloje drogash njeh? a) Asnjë. b) 1 – 5. c) 5 – 10.

3. A mendon që marihuana është drogë? a) Po. b) Jo. c) Nuk e di.

4. A është e lehtë të gjesh drogë në ambientin ku ti jeton/mëson? a) Po. b) Jo. c) Nuk jam i sigurt.

5. A e din që droga është e ndaluar me ligj? a) Po. b) Jo. c) Nuk jam i sigurt. 6. Pse sipas mendimit tënd, të rinjët fillojnë të marrin drogë? a) Mungesë njohurie dhe informacioni. b) Problemet në shkollë dhe në familje. c) Kureshtja. d) _____ (diçka tjetër).

7. A ke konsumar ti ndonjëherë drogë, e nuk e ke ditur se çfarë është? a) Po. b) Jo. c) Nuk jam i sigurt.

8. Si do ta njihje personin që merr drogë, nga çka? a) Nga sytë. b) Nga sjellja. c) _____ (nga diçka tjetër)

9. A e njeh ti ndonjë person që merr drogë? a) Po b) Jo 10. Kur je në shoqëri me njerëz që përdorin drogë... a) Të pengon. b) Të disponon. c) _____ (diçka tjetër)

11. Sikur ta merrje vesh që shoku yt merr drogë, kujt do t'i tregojë për këtë? a) Jo nuk do t'i tregojë askujt. b) Prindërve. c)

_____ (dikujt tjetër)

12. Nga i merr më së shpeshti informacionet për drogën? a) Nga mjetet e informimit (mediat). b) Nga rrethi shoqëror. c)

_____ (nga dikush tjetër)

13. E shikoni konsumimin e drogës si mënyrë për t'u larguar nga problemet?

a) Po b) Jo

14. Sipas mendimit tënd, kush është më kompetent të flasë për këtë problem? a) Prindërit. b) Shkolla. c) Mediat. d) Ata që dikur kanë konsumuar drogë. e)

_____ (dikush tjetër)